



UNIVERSITETI

I SHKENCAVE TË APLIKUARA

— FERIZAJ —

Nr. prot.: 1543/20, Datë: 14.08.2020

Në bazë të nenit 8 të Ligjit të Punës, numër 03/L-212, nenit 8 pika 3 nënpika 3.5 të Ligjit për Arsimin e Lartë, numër 04/L-037, si dhe nenit 140 pika 4 të Statutit të Përkohshëm të Universitetit të Shkencave të Aplikuara në Ferizaj (UShAF), në përputhje me Rregulloren për procedurat përzgjedhëse për emërim, riemërim dhe avancim të personelit të rregullt akademik, Senati i UShAF në mbledhjen e mbajtur me 12.08.2020, vendosi që të shpallë:

K O N K U R S

Për zgjedhjen e personelit të rregullt akademik

I. MËSIMDHËNËS NË MARRËDHËNIE TË RREGULLT PUNE

1. Një mësimitdhënës për lëndët: Ergonomia dhe Dizajni i Mobilieve; Ergonometria; Qëndrueshmëria dhe Ekologjia (Resurset Natyrore); Trashëgimia Historike dhe Kulturore.
2. Një mësimitdhënës për lëndët: Kontabiliteti; Bazat e Kontabilitetit; Menaxhimi i Financave.
3. Një mësimitdhënës për lëndët: Menaxhimi i Projekteve Inxhinierike; Menaxhimi i Dijës dhe Inovacionit; Modelimi në 3D dhe Vizualizimi.

Kushtet e përgjithshme

Kushtet e përgjithshme për zgjedhjen e personelit akademik të rregullt janë të përcaktuara në dispozitat e Statutit të Përkohshëm të UShAF dhe Rregulloren për procedurat përzgjedhëse lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit të rregullt akademik në UShAF, Nr. prot.: 2641/19, datë: 01.08.2019.

Dokumentet e nevojshme për aplikim:

Kandidatët të cilët paraqiten në konkurs duhet t'i paraqesin këto dokumente:

- a) Kërkesën për aplikim dhe biografinë (CV),
- b) Certifikaten e lindjes (Origjinale-jo më të vjetër se 6 muaj),

- c) Diploma origjinale (bachelor, master/magjistraturë dhe doktoratë) ose kopjet e tyre të noterizuara.
- d) Vendimin për nostrifikim (barasvlerën), origjinal ose të noterizuar të diplomës përkatëse (bachelor, master/magjistraturë, doktoratë) nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës së Republikës së Kosovës, për të gjithë kandidatët që i kanë mbaruar studimet jashtë vendit. Nuk do të merret në konsideratë dëshmia e aplikimit për nostrifikim.
- e) Dëshmitë për publikimet shkencore e profesionale brenda kornizës së përcaktuar me Statutin e UShAF dhe Rregulloret përkatëse.
- f) Certifikatë nga organet kompetente që personi nuk është nën hetime, aktuale (origjinale).
- g) Informata tjera shtesë, të cilat janë të rëndësishme për kandidatët që aplikojnë.

Kohëzgjatja e emërimit dhe kufizimet për emërim

1. Të gjitha emërimet për tituj, si dhe kohëzgjatja e punësimit bëhen në përputhje me dispozitat përkatëse të Statutit të UShAF dhe ligjeve në fuqi.

Vendimi, periudha e ankimimit dhe përmbyllja e konkursit

1. Kandidatët, të cilët janë të pakënaqur me vendimet e organeve kompetente të UShAF-it (Këshillit Mësimor/Shkencor apo Senatit), gjatë përzgjedhjes së personelit akademik kanë të drejtë ankese në dy faza:
 - a) Faza e parë e ankimimit është më së largu 15 ditë nga dita e publikimit të Buletinit. Buletini do të qëndrojë i publikuar 15 ditë në Zyrën nr. 007 të UShAF dhe në ueb-faqen e UShAF. Ankesa i drejtohet Komisionit për Ankesa të Këshillit Mësimor/Shkencor në UShAF dhe do të shqyrtohet nga Këshilli Mësimor/Shkencor, më së largu 10 ditë nga dita e përmbylljes së afatit të ankimimit.
 - b) Faza e dytë e ankimimit bëhet ndaj vendimit të Senatit, në afat jo më larg se pesëmbëdhjetë (15) ditë pas pranimit në dorëzim të vendimit. Ankesa i drejtohet Komisionit të Senatit për Ankesa dhe Parashpresa, që shërben si instancë e parë dhe e fundit e ankimimit në UShAF. Raporti i ankesave të shqyrtuara nga Komisioni i Ankesave dhe Parashpresave i prezantohet Senatit për vendosje përfundimtare në nivel të organeve të UShAF. Propozimi i Komisionit të Senatit për Ankesa dhe Parashpresa nuk ka karakter obligativ për Senatin.
2. Pala ankuese njoftohet me shkrim lidhur me vendimin përfundimtar të Senatit.

3. Konkursi për emërim, riemërim ose avancim për personelin akademik të rregullt, duhet të përmbyllet me vendime përkatëse të Senatit të UShAF për të gjitha vendet e shpallura, në një periudhë jo më të gjatë se 175 ditë nga dita e shpalljes.
4. Për raste të veçanta, para arritjes së propozimit në Senat, me kërkesë të Rektorit, afati i të gjithë procedurës mund të zgjatet maksimalisht edhe 30 ditë.
5. Nëse konkursi nuk realizohet në tërësi apo pjesërisht brenda afatit të përcaktuar si në paragrafin 3, atëherë vendet përkatëse të porealizuara mund të rishpallen në konkursin e radhës sipas kërkesës së Fakultetit.

Mënyra e aplikimit

1. Aplikantët duhet të dorëzojnë dokumentet e nevojshme në formë të shtypur dhe në formë elektronike.
2. Dokumentacioni në formë fizike (i shtypur), për çdo vend pune në të cilin aplikon kandidati, përveç atij origjinal ose të noterizuar, duhet të dorëzohet edhe një kopje e thjeshtë fizike shtesë.
3. Dokumentacioni i shtypur duhet të dorëzohet në administratën e UShAF-it, zyra nr. 007, kurse versioni elektronik në adresën zyrtare të UShAF (info@ushaf.net).
4. Punimet shkencore të publikuara në revista ndërkombëtare duhet të skanohen në tërësi, ndërsa për libra të botuar duhet të skanohet faqja e parë e librit dhe faqja në të cilën shihet katalogimi i botimit.
5. Aplikacionet e arritura pas afatit dhe ato të pakompletuara, si dhe ato që nuk deponohen të skanuara përmes postës elektronike në adresën e lartëcekur, nuk do të merren në shqyrtim.
6. Konkursi mbetet i hapur 15 (pesëmbëdhjetë) ditë kalendarike nga dita e publikimit në shtypin ditor, përkatësisht nga data 17.08.2020 deri më 31.08.2020, ora 16:00.